STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 25 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE OCEAN PARKWAY DO TE RIHAPET PER ORET E PIKUT TE MENGJESIT TE NESERM

Rruga hapet me kufizime të korsive pas dëmit të pashembullt nga Urgani Sendi (Sandy); restaurimi i plotë të përfundojë përpara Ditës së Përkujtimit

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se riparimet urgjente në Ocean Parkway në Long Ajlënd (Long Island) kanë përfunduar dhe rruga do të hapet në kohë për pikun e mëngjesit, të hënën 26 nëntor, me kufizime të korsive dhe të shpejtësisë.

Rruga 15.5 milje e gjatë, që siguron hyrjen në Jones Beach, Robert Moses State Park, vende të tjera të preferuara të zbavitjes dhe komunitete banimi përgjatë një pjese të bregdetit jugor të Long Ajlënd (Long Island), pësoi dëm të pashembullt gjatë Uraganit Sendi (Sandy) muajin e kaluar.

“Hap pas hapi infrastruktura e shtetit tonë është duke u restauruar pas shkatërrimit katastrofik të shkaktuar nga Uragani Sendi (Sandy),” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Falënderoj individët nga Departamenti i Transportit i Shtetit të Nju Jorkut dhe nga Zyra e Parqeve, Zbavitjes dhe Ruajtjes Historike të Shtetit të Nju Jorkut që kanë punuar pa pushim që nga Uragani Sendi (Sandy) për të bërë riparime urgjente në rrugë, në mënyrë që të rihapet për udhëtarët së më shpejt që të jetë e mundur.”

NYSDOT, NYSOPRHP dhe Departamenti i Mbrojtjes Mjedisore janë duke punuar me Administratën e Autostradave Federale dhe Korpusin e Inxhinierëve të Ushtrisë për të krijuar një projekt të mbrojtjes të pengesës bregdetare të riparimit të rrugës për të rikthyer Ocean Parkway në kushtet e saja përpara stuhisë. Kjo do të përfshijë zëvendësimin e pjesës prej dy milje të rrugës të shkatërruar pranë Gilgo Beach dhe rivendosjen e dunave mbrojtëse ndërmjet rrugës dhe oqeanit.

NYSDOT dhe NYSOPRHP gjithashtu janë duke bashkëpunuar për të krijuar një projekt për të rindërtuar korsitë e dëmtuara në rrethin e trafikut në Robert Moses State Park. Kostoja paraprake e përllogaritur e punës për restaurimin e Ocean Parkway dhe të rrethit të trafikut është 35 milionë dollarë dhe të dyja do të përfundojnë deri në Ditën e Përkujtimit. Pritet që qeveria federale të sigurojë ndarjen e kostos për projektin dhe NYSDOT është duke punuar me Administratën e Autostradave Federale dhe agjenci të tjera federale për të përcaktuar kualifikimin për financim federal.

Shteti i Nju Jorkut është duke shqyrtuar alternativa për të forcuar ato pjesë të dunave mbrojtëse të rërës që u dëmtuan për të siguruar stabilitet dhe qëndrueshmëri ndaj stuhive të ardhshme. Përfundimi i një projekti të madh të gërmimit në Fire Island Inlet, që do të sigurojë rërë për restaurimin e plazheve dhe dunave të dëmtuara, është një pjesë vendimtare e strategjisë afat-gjatë për mbrojtjen e Ocean Parkway dhe Robert Moses State Park. Përveç sigurimit të rërës së nevojshme, projekti i gërmimit gjithashtu do t'a bëjë Fire Island Inlet të sigurtë për ankorimin tregtar dhe për zbavitje.

"Ocean Parkway dhe plazhet tona në buzë të oqeanit kanë një rëndësi vendimtare për ekonominë dhe për cilësinë e jetës për Long Ajlënd (Long Island) dhe për Shtetin tonë. Gërmimi në Fire Island Inlet, ringjallja e plazhit dhe ndihma federale të gjitha do të luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e vetvetes dhe lehtësimin e pasojave shkatërrimtare që vijnë nga një stuhi si Sendi (Sandy)," tha Komisionerja e NYSOPRHP Rouz Harvi. "Ocean Parkway jo vetëm siguron hyrjen fizike në plazhet, parqet dhe komunitetet tona, por është hyrja jonë mendore në krijimin e kujtimeve që zgjasin gjithë jetën me familjen dhe miqtë tanë. Rihapja e Ocean Parkway është një hap vendimtar në përpjekjet e rimëkëmbjes së Shtetit."

Fusha 2 në Jones Beach është rihapur për publikun dhe Fusha 6, e preferuar për shumë, pritet të hapet këtë javë. Punonjësit e parkut ende janë duke pastruar parqet dhe stolat dhe kanë mbyllur zonat që konsiderohen jo të sigurta për t'u vizituar për të mbrojtur ata që kthehen. Robert Moses State Park mbetet i mbyllur, por pritet që hyrja tek ai të rihapet deri në Ditën e Përkujtimit kur të shtohet trafiku.

"NYSDOT është i përkushtuar që të punojë me partnerët tanë në nivelet shtetërore, federale dhe vendore për të rindërtuar Ocean Parkway, që transporton pothuajse 10 milionë vizitorë çdo vit në plazhet dhe parqet përgjatë bregdetit jugor të Long Ajlënd (Long Island)," tha Komisionerja e NYSDOT Xhoen Mekdonëlld. "Gjithashtu do t'u kushtojmë vëmendje alternativave për përmirësimin e pengesës mbrojtëse të rrugës si reagim ndaj shpeshtësisë në rritje të motit të ashpër, gjë që është një hap i nevojshëm në mënyrë që të minimizojmë dëmin e ardhshëm në këtë rrugë të rëndësishme. Për shkak të udhëheqjes së Guvernatorit Kuomo (Cuomo), jemi duke kërkuar të bëjmë përmirësime në të gjithë sistemin në vend që të punojmë në çdo riparim veçmas, gjë që është një shembull i mirë i metodës së mishëruar në programin e tij Punët e NY."

Ocean Parkway ka qënë e mbyllur që më 30 tetor. Rreth pesë milje të pjesës drejt lindjes të rrugës dhe dunat mbrojtëse të rërës së saj u dëmtuan rëndë; një gjysmë milje e rrugës dhe 1.6 milje e dunave të rërës në lindje të Gilgos u shkatërruan plotësisht. Menjëherë pas Uraganit Sendi (Sandy), NYSDOT filloi një projekt urgjent për të restauruar dy milje të dunave të rërës ndërmjet plazheve Gilgo dhe West Gilgo përpara sesa një Noristër (Nor'easter) të godiste më 6 nëntor. Kjo punë e restaurimit urgjent ka të ngjarë të ketë shpëtuar Ocean Parkway dhe shtëpitë në veri nga dëmi tjetër.

Duke filluar që sot, qarkullimi i trafikut në të dyja drejtimet me një korsi të vetme në çdo drejtim do të fillojë në pjesën e padëmtuar drejt perëndimit të Ocean Parkway për 4.8 milje ndërmjet Cedar Beach dhe Tobay Beach. Trafiku drejt perëndimit do të pakësohet në një korsi të vetme pranë Cedar Beach deri

në perëndim të Tobay Beach. Trafiku drejt lindjes do të kalojë nga tre korsi udhëtimi në një korsi udhëtimi pranë Tobay Beach, pastaj do të kalojë në rrugën drejt perëndimit duke përdorur një rrethkalim të ndarjes ekzistuese të qendrës. Në Cedar Beach, trafiku drejt lindjes pastaj do të drejtohet përsëri në rrugën drejt lindjes duke përdorur një rrethkalim të ndarjes ekzistuese. Rruga do të funksionojë normalisht në të dyja drejtimet për pothuajse 4 milje ndërmjet kullës së ujit të Wantagh State Parkway/Jones Beach dhe Tobay Beach.

Kufiri i shpejtësisë do të pakësohet në 35 milje në orë për të gjithë gjatësinë e rrugës. Shoferave u bëhet thirrje të kenë kujdes kur udhëtojnë në këtë zonë dhe të jenë të përgatitur për të ndaluar. Rruga Ocean Parkway drejt lindjes ndërmjet plazheve Tobay dhe Cedar do të mbetet e mbyllur derisa të përfundojë restaurimi.

Sipas udhëzimit të Guvernatorit Kuomo (Cuomo), Departamenti i Transportit i Shtetit të Nju Jorkut pati mesatarisht 1,650 njerëz të personelit duke punuar pa pushim në pikun e reagimit ndaj Uraganit Sendi (Sandy) për të pastruar dhe rihapur autostradat e dëmtuara. Pas stuhisë, NYSDOT më 30 tetor kishte 163 rrugë të mbyllura në Luginën Hadson (Hudson) Long Ajlënd (Long Island) dhe Qytetin e Nju Jorkut. Brenda një jave, të gjitha përveç nëntë autostradave shtetërore ishin rihapur për trafikun. Me rihapjen sot të Ocean Parkway, mbetet vetëm një mbyllje e pjesshme, Nënkalimi i Battery Park.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418